



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
MUNICIPALITY OF KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

09.01/20	Vendi	Kaçanik
01 Nr. 60/01-39809/19	Numri	Shtetçi

PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Kemal Mërseli

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së XII-të (Dymbëdhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 27 Dhjetor 2019.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e XII-të (Dymbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë: 27 Dhjetor 2019, dhe atë:

1. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020/ Lënda: 01Nr. 60/01-39401/19;
2. Vendimi për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020 / Lënda: 060/01-39074/19;
3. Vendimi për Aprovimin e Planit Vjetor i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Kaçanikut për vitin 2020/ Lënda: 01Nr.60/01-39691/19;
4. Vendimi për Aprovimin e Plani i Veprimit për Transparencë 2020-2023/ Lënda: 01Nr.104/02-39584/19;
5. Vendimi për Ndryshimin e Statusit aktual të KRU "Bifurkacioni" nga Ndërmarrja publike lokale në Ndërmarrje publike qendrore/ Lënda: 01Nr.07-104/02-39515/19;
6. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës / Lënda: 01Nr. 08-322/01-39425/19;
7. Propozim Vendimi për përmirësimin e gabimit teknik të Vendimit të KK 01Nr. 941/01-34155/2019 të datës 31.10.2019 për këmbimin e pronës komunale me pronën private në emër të Razim Palloshi nga f. Biçec / Lënda: 01Nr. 941/01-39854/19.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-39401/19
Kaçanik, 27.12.2019

Në bazë të nenit 40.2(d) të Ligjit Nr. 03L-/040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28 /04 Qershor 2008 e Republikës së Kosovës), të neneve 34.5 dhe 36 lidhur me nenet 40, 41 dhe 42 të Statutit të Komunës 01Nr. 3588/2008 të datës 25.09.2008 si dhe nenit 15(c) lidhur me nenin 24 të Rregullores për Punë të Kuvendit, të Propozim Vendimit të Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020, në mbledhjen e mbajtur me 10 Dhjetor 2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 Dhjetor 2019, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2020

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2020.
2. Plani vjetor i cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban; numrin e mbledhjeve, pikat – temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit, vendi dhe ora e mbajtjes, kryesimi i mbledhjeve si dhe Buxhetin e aprovuar të kuvendit të komunës për aktivitetin e kuvendit dhe trupave punuese të tij, për vitin 2020.
3. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në vitin 2020, planifikon t'i mbajë gjithsej, 12 Mbledhje të Rregullta. Çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës i paraprinë Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.
4. Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës, do të mbahen sipas këtij Plani të Punës:

**PLANI I MBLEDHJEVE TË KUVENDIT
PËR VITIN 2020**

Nr.	Mbledhjet	Periudha Kohore	Vendi i mbajtjes	Ora	Rendi i Punës	Kryesimi i mbledhjeve
1	2	3	4	5	6	7
01.	Mbledhja e I	Javën e fundit të muajit janar	Katin i III Salla e KK	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e 12 e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Plan i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020; 3. Informatë e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor, 2018/2019; 4. Informatë për performancën e Komunës për vitin 2019; 5. Raport i Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për aktivitetin e zhvilluar në vitin 2019; 6. Raportit (Informatë) Final Financiar i Komunës për vitin 2019; 7. Informatë për zbatimin e planit të integritetit; 8. Propozim Vendim për pagesën e Komisioneve të Kuvendit të Komunës; 9. Iniciimi i procedurës për themelimin e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve.	Kryesuesi i KK
02.	Mbledhja e II	Javën e fundit të muajit shkurt	- - -	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I e Rregullt e Kuvendit të Komunës ; 2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019; 3. Informatë e Zyrës së Personelit për aktivitetin e zhvilluar në vitin 2019 ; 4. Raporti i Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2019;	- - -

						5. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019; 6. Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2020; 7. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2019, në vitin 2020; 8. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 9. Informatë mbi zbatimin e Ligjit kundër duhanit në territorin e Komunës së Kaçanikut.		
03.	Mbledhja e III	Javën e fundit të muajit mars	--	11:00		1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e II-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti (Informatë) i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2019; 3. Raporti i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019; 4. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës.	--	
04.	Mbledhja e IV	Javën e fundit të muajit prill	--	11:00		1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti Tremujor Financiar i Komunës, Janar – Mars 2020; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës.	--	

05.	Mbledhja e V	Javën e fundit të muajit maj	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IV-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregullloreje apo Propozim Vendimi të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës; 3. Informatë mbi Qarkoren e I (Parë) Buxhetore të Ministrisë së Financave; 4. Informatë për aktivitetin e komiteteve funksionale të kuvendit; dhe 5. Informatë për zbatimin e Rregullores për mbrojtjen e drejtave të fëmijëve.	--
06.	Mbledhja e VI	Javën e fundit të muajit qershor	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e V-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Komiza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KAB) për vitet 2021-2023; 3. Propozim Vendimi për Rishikimin e Buxheit të Komunës për vitin 2020; 4. Shqyrtimi i Raportit (Informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së; 5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregullloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 6. Informatë për realizimin e Planit të Prokurimit.	--

07.	Mbledhja e VII	Javën e dytë të muajit korrik	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VI-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Raporti Gjashtëmujor Financiar, Janar - Qershor 2020; 3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2019; 4. Plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas Raportit të Auditorit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019; 5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 6. Informatë e DAK për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020.	--
08.	Mbledhja e VIII	Javë e fundit e muajit korrik			1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VII-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Informatë për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2020; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 4. Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrigjimit; 5. Informatë për aktivitetin e Zyrës për Barazi Gjinore.	
09.	Mbledhja e IX	Javën e fundit të muajit shtator	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VIII e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2021; 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2021; 4. Raporti i zbatimit të Rekomandimeve të Raportit të Auditorit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019; 5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; dhe 6. Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor,	--

					2020-2021.	
10.	Mbledhja e X	Javën e fundit të muajit tetor	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IX e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës, Korrik – Shtator 2020; 3. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës.	
11.	Mbledhja e XI	Javën e fundit të muajit nëntor	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e X e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Rregulloreje apo Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 3. Informatë e DUKMM për procesin e legalizimit të objekteve të ndërtimit; 4. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi gjendjen e përgjithshme të komunës; 5. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë për të mbjellat vjeshtore.	
12.	Mbledhja e XII	Periudha; 19 - 24 Dhjetor 2020	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XI e Rregullt e Kuvendit të Komunës; 2. Propozim Plan i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021; 3. Propozim Plan i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2021; 4. Propozim Plan i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2021; 5. Shqyrtimi i ndonjë Propozim Vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës; 6. Informatë e KKSBB për aktivitetin e zhvilluar; 7. Informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2020. 7. Informatë për funksionimin e këshillave lokale.	

4. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës caktohen nga Kryesuesi i Kuvendit, në konsultim me Kryetarin e Komunës.

4.1. Minimumi i mbledhjeve të Rregullta të Kuvendit të Komunës për një vit kalendarik është 10 Mbledhje të Rregullta, prej tyre se paku 5 Mbledhje të Rregullta duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik, sipas LVL neni 43.2.

4.2. Maksimumi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës me karakter pune, me pagesë për një vit kalendarik është 12 Mbledhje.

5. Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjatë vitit 2020, i ka paraparë me Planin e Punës me i mbajtur gjithsej 12 Mbledhje me pagesë.

5.1. Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera më shumë se 12 Mbledhje të rregullta, por nga mbledhja e 13 të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës me karakter pune, e rregullt apo jo e rregullt, do të jenë pa pagesë.

5.2. Aktiviteti i zhvilluar i Kuvendit të Komunës është barrë e Buxhetit të Komunës, për vitin 2020 nga Programi buxhetor, Zyra e Kuvendin e Komunës, për; Për Paga dhe Mëditje dhe për: Mallra dhe Shërbime;

5.3. Shpenzimet: Për Paga dhe Mëditje do të paguhet:

5.3.1. Paga mujore e Kryesuesit të Kuvendit për 12 muaj.

5.3.2. Paushall mujor për anëtarët e KK sipas akteve në fuqi.

5.3.3. Kompensimi i mëditjeve për 12 Mbledhje të Kuvendit për 26 anëtarë të Kuvendit, për pjesëmarrje në mbledhje,

5.3.4. Kompensimi i mëditjeve për 12 Mbledhje të KPF për 6 anëtarë, për pjesëmarrje në mbledhje.

5.3.5. Kompensimi i mëditjeve për 10 Mbledhje të Komitetit për Komunitete për 7 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje.

5.3.6. Kompensimi i mëditjeve për 6 Mbledhje të Komitetit për Shërbime Publike për 5 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje.

5.3.7. Kompensimi i mëditjeve për 6 mbledhje të Komitetit Konsultative për Persona me Aftësi të Kufizuara, për 7 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje.

5.3.8. Nëse mungon anëtari në mbledhje të Kuvendit apo të Komiteteve, heqja e mëditjes do të bëhet në pajtim me aktet në fuqi.

5.4. Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime janë në shumë me Buxhetin e Komunës të vitit 2020, ku përfshihen:

5.4.1. Shpenzime të furnizimit për zyre dhe blerje tjera mallra e shërbime;

5.4.2. Shpenzime për dreka zyrtare, ku përfshihen: Shpenzimet e bufesë për Zyrën e Kryesuesit, Shpenzimet për Ujë dhe Pije për Mbledhje të Kuvendit dhe Komitete të Kuvendit, Shpenzimet për Debatin Publik të organizuar me qytetarë të komunës, për buxhetin e komunës për vitin 2021 dhe Projeksionet për vitin 2022-23 (ujë dhe pije), organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit.

5.4.3. Shpenzime të tjera: udhëtime zyrtare jashtë vendit, informimit publik, marketing, botime e publikime dhe shpenzime të përfaqësimit.

6. Të gjitha mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen vetëm ditëve të punës.

6.1. Materialet që i adresohen Kuvendit të Komunës, janë kryesisht çështje të propozuara nga ekzekutivi i komunës, e që kalojnë procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të KPF-s, dhe të njëjtat, me Rekomandim të KPF-s i kalojnë Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim apo në procedurë të mëtejme.

6.1. Njoftimet për mbledhje të Kuvendit të Komunës bëhen publike.

6.2. Materialet për Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit të Komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

6.3. Njoftimet dhe Materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

7. Ky Plan Pune i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, është Plan orientues edhe për mbledhjet e KPF-s, të cilat mbledhje do të mbahen se paku 3 ditë para mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, me të gjitha pikat e propozuara, me përjashtim të Procesverbalit të mbledhjeve të Kuvendit, Planeve dhe Raporteve të trupave punuese të KK.

8. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në muajin shtator do të mbajë Dëgjim Publik me qytetarë, për Propozim-Buxhetin e komunës për vitin 2021 dhe Projektionet për vitet: 2022-2023, para se të aprovohet buxheti në kuvend.

9. Të gjitha mbledhjet e Rregullta të KK do të jenë hapura për: qytetarë, media dhe për çdo të interesuar tjetër.

9.1. Nëse ndonjë mbledhje e Rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura, atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës.

9.2. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarë të komunës, mediat dhe të interesuar të tjerë, në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

11. Kuvendi i Komunës për gjatë muajit gusht, do të jetë në Pushim Vjetor.

11.1. Për fillimin dhe mbarimin e pushimit, Kuvendi i Komunës do të njoftohet paraprakisht.

11.2. Për gjatë pushimit(muajin gusht) nuk planifikohet mbajtja e ndonjë mbledhje përveç nëse paraqitet ndonjë çështje eventuale, atëherë nuk përjashtohet mundësia të mbledhet Kuvendi i Komunës.

12. Plani i përcaktuar i Kuvendit të Komunës për vitin 2020, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime varësisht nga kërkesat dhe nevojat që paraqiten.

13. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

 Kryesuesi i Kuvendit
Kema Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr.60/01-39691/19

Kaçanik: 27.12.2019

Në bazë të nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 27 Dhjetor 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR VITIN 2020

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2020, i propozuar nga ky Komitet Konsultativ.
2. Në Planin e Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (KKPAK) janë paraqitur objektivat që parashihen t'i realizoj ky komitet në mbledhje të rregullta dhe aktivitete të tjera, treguesit, mjetet e verifikimit, institucionet zbatuese dhe afatet kohore të realizimit.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është: Plani i Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2020 i përmbledhur në gjithsej 6 faqe/ Lënda: 01Nr.60/01-39691/19.
4. Për realizimin e Planit të Punës së Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, do të kujdeset KKPAK dhe organet tjera relevante të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Data	18.12.19	Vendi	KAÇANIK
Numri	01	Shtojcë	60/01-39691 /

Data / Datum	18.12.2019
Për / Za	Kuvendin e Komunës- Kaçanik
Përmes / Preko	Artan MEZRAJA, Kryesues i KKPAK -Kaçanik
Nga / Od	Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara
Kopje / Kopija	
Lënda / Predmet	Informat; Plani i Punës së Komitetit Konsultativ për PAK-të-Kaçanik 2020

Të nderuare;

Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik e ka hartuar planin e punës për vitin 2020, andaj si material përcjellës të kësaj shkrese të bashkangjitur e keni edhe planin vjetor të punës së këtij komiteti.

Me respekt;

Artan Mezraja

Kryesues i KKPAK-Kaçanik.



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik

Plani Vjetor i Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik 2020

Dhjetor, 2019

Përmbajtja

1.Hyrje.....	3
2.Mbledhja.....	4
3.Tryeza.....	4
4.Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.....	4
5.Vizitat.....	5
6.Aktivitetet Sensibilizuese.....	5
7.Edukimi.....	5
8.Promovimi i çështjes së aftësisë së kufizuar.....	6
9. Trajnimet.....	6
10. Shtojca ; Aktivitetet në formë tabelare.....	7-8

Hyrje

Si njëra nga mënyrat e pjesëmarrjes në qeverisjen demokratike të një vendi (komune) janë edhe komitetet konsultative, pra, ata paraqesin “njërën nga elementet qenësore të modelit të qeverisjes demokratike”. Përmes komiteteve konsultative tentohen të arrihen dy objektiva: e para pjesëmarrja e drejtpërdrejt e qytetarëve në vendimmarrje dhe e dyta sigurimi i kapaciteteve të munguara të institucioneve komunale në raport me fushat e caktuara.

Si i tillë është themeluar edhe Komiteti Konsultativ Për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, me dt. 13.09.2019. Ky komitet ka për qëllim adresimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në radhë të parë tek institucionet komunale vendimmarrëse siç janë ekzekutivi (Kryetari i Komunës) dhe legjislativi(Kuvendi Komunal). Ndërsa, si funksione kryesore të komitetit konsultativ janë: dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme; hulumtime të ndryshme; mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës; komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse; paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve persona me aftësi të kufizuara tek Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës; propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Në funksion të arritjes së këtyre objektivave dhe qëllimeve hartohet ky plan i punës njëvjeçare të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik.

1. Mbledhjet

Si njëra nga metodat e punës do të jenë edhe mbledhjet e komitetit ku do të diskutohen aktivitetet dhe çështjet e ndryshme të punës së komitetit si dhe çështje të tjera të paraqitura eventuale në drejtim të komitetit ose edhe veprimet ose vendimet e ndërmarra nga autoritet komunale që kanë impakt në jetën e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara. Pra, do të trajtohen çështjet e personave me aftësi të kufizuara të komunës së Kaçanikut.

Bazuar në “Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 Për Procedurën e Themelimit, Organizmit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna” është e normuar numri i mbledhjeve të këtyre komiteteve në atë “ Mbledhjet mbahen varësisht nga nevoja, por së paku duhet të mbahen gjashtë(6) takime në vit”.

Si afate tentative të përcaktuara mund të jenë: Java e fundit e muajit shkurt ; java e fundit e muajit prill; java e fundit e muajit qershor; java e fundit e muajit shtator; java e fundit e muajit nëntor; java e parë e muajit dhjetor.

2.Tryeza

Si formë tjetër nga aktivitetet e komitetit do të jenë edhe organizimi i tryezave në formate të ndryshme në të cilat do të tentohen të identifikohen problemet, si dhe sfidat e çështjes së aftësisë së kufizuara. Por, gjithashtu përmes këtyre diskutimeve synohet të arrihet edhe sensibilizimi i tematikave të personave me aftësi të kufizuara, dhënia e ideve dhe adresimi i këtyre ideve tek autoritetet vendimmarrëse. Target grupet e synuara në këto tryeza janë të kushtëzuara varësisht temës së diskutimit megjithatë si target grupe do të jenë: personat me aftësi të kufizuara, institucionet komunale, institucionet qendrore, organizatat e shoqërisë civile, kompanitë dhe bizneset private.

Koha e mbajtjes tentohet të jetë muaji maj dhe dhjetor, pra qëllimi është organizimi i së paku dy tryezave.

3.Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik.

Si dokument referues mbi problemet, sfidat por edhe alternativat e zgjidhjes së tyre është dokumenti: Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik i miratuar nga Kuvendi Komunal në Kaçanik në tetor të vitit 2018. Në funksion të realizimit të këtij plani përkatësisht objektivave të tij, Komiteti Konsultativ do të bënë monitorimin e zbatimit të këtij plani.

Ky aktivitet realizohet përmes takimeve të drejtpërdrejta me bartësit e zbatimit të secilës objektiv të planit të veprimit, por edhe përmes vrojtimit të drejtpërdrejt të gjendjes faktike që ka të bëjë me jetën e personave me aftësi të kufizuara.

4. Vizitat

Komiteti Konsultativ për gjatë aktiviteteteve të saj mëton të realizon një sërë vizitash përgjatë vitit 2020.

Vizitat nëpër institucionet komunale, me qëllim identifikimin por edhe sensibilizimin e aftësisë së kufizuar tek autoritete komunale dhe të tjerëve.

- a) Vizitat nëpër organizata joqeveritare me fokus tek organizatat që merren me çështjen e aftësisë së kufizuar. Qëllimi i këtyre takimeve është identifikimi i problemeve dhe mënyrat e avokimit të këtyre tek autoritetet vendimmarrëse. Krijimi i një aleance ndërmjet komitetit dhe OJQ-ve.
- b) Vizitat nëpër institucionet qendrat ditore për personat me aftësi të kufizuar. Qëllimi i këtyre vizitave është studimi i punës dhe aktiviteteteve që zhvillohen në këto qendra.
- c) Vizitat nëpër shkollat speciale në Kaçanik. Qëllimi është njohja me nxënësit por edhe me gjendjen në të cilën ata marrin mësimin.
- d) Vizita nëpër Komitetet Konsultative në Komunat tjera të Kosovës, ku qëllimi i këtyre do të ishte marrja dhe dhënia e përvojave të punës së komitetit si dhe evidenca e problemeve të personave me aftësi të kufizuar si dhe synimi i një avokimi më të përgjithshëm drejt realizimit të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.

5. Aktivitete sensibilizuese

Në kuadër të aktiviteteteve si shenjë sociale do të jenë edhe shënimi i datës së 3 dhjetorit si dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuar. Për mos duplikim të aktiviteteteve do të realizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë në objektiva pune personat me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, edhe përmes Javës së Rinisë e cila tradicionalisht në Kaçanik mbahet në muajin shtator KKPAC do të bëjnë aktivitete që kanë për qëllim sensibilizimin e masës, konkretisht të rinjve për aftësinë e kufizuar.

6. Edukimi

Si njëra nga objektivat kryesore të këtij komiteti do të jetë jo vetëm adresimi dhe avokimi i çështjes së aftësisë së kufizuar në institucionet komunale por edhe adresimi i kësaj fushe edhe tek komunitet tjera të shoqërisë në mënyrë që pjesa e paragjykimeve dhe stereotipave të jetë në minimumet e veta. Në funksion të kësaj komiteti do të organizon ligjërata edukuese me nxënësit e shkollave të mesme dhe atyre fillore me tema të ndryshme që kanë të bëjnë me thirrjen për barabarësi të gjitha kategorive të njerëzve brenda shoqërisë.

Ndërsa si formë tjetër do të jetë edhe edukimi shëndetësor i personave me aftësi të kufizuar por edhe të familjareve të tyre në raport me nevojat e personave me aftësi të kufizuar.

7. Promovimi i çështjes së aftësisë së kufizuara

Si pjesë e punës së këtij komiteti do të jetë edhe aktivizimi i një faqe dhe mirëmbajtja e saj në të cilën do të paraqiten aktivitetet e komitetit por edhe mendimet e saj në raport me çështjet e personave me aftësi të kufizuara, Gjithashtu, komiteti do të pasqyron punën e saj dhe problemet e aftësisë së kufizuara edhe në rrjetet sociale të komunës por edhe atyre lokale. Pjesëmarrja e anëtarëve të këtij komiteti në media dhe konferenca të ndryshme do të jetë njëra nga mënyrat e punës.

7.Trajnimet;

Pavarësisht dijes ekzistuese dhe në funksion të përmirësimeve të kapaciteteve të këtij komiteti do të tentohet që anëtarët e këtij komiteti të aftësohen në trajnime të ndryshme të ofruara në tregun e trajnimeve në Kosovë. Mirëpo, kjo është e kushtëzuar edhe nga çmimet dhe mundësitë buxhetore të KKPAK-së për të i ndjekur këto trajnime që kanë të bëjnë me njohjen më të mirë të çështjes së aftësisë së kufizuara por edhe marrjen e njohurive mbi adresimin sa më profesional të tyre.

Shtojca; Aktivitetet në formë tabelare;

Aktiviteti	Treguesit	Mjetet e verifikimit	Institucioni zbatues	Afati Kohor	Verejtje
1. Mbledhjet	1. Çështjet e trajtuara 2. Numeri i mbledhjeve	Lista e nenshkrimeve, procesverbalet	Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (tutje KKPAA)	Shkurt, Prill, Qershor Shtator, Nentor, Dhjetor	Mund të mbahen edhe mbledhje të jashtzakonshme...
2. Tryeza	1. Numeri i tryezave të mbajtura	Lista e nenshkrimeve, foto, raportet	KKPAA	Maj dhe Dhjetor	
3. Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kacanik.	1. Numeri objektivave të monitoruara; 2. Numeri i objektivave të arritura	Raporti i Monitorimit në fund vit.	DSHMS QKMF	Janar deri Dhjetor	
4. Vizitat	1. Vizita tek KKPAA-të homologe 2. Vizita tek OJQ-të për PAK-të 3. Vizita tek institucionet komunale 4. Vizita tek kompanit private	Raportet, fotografit etj.	KKPAA	Janar-dhjetor	Perpos këtyre institucioneve të përmenduar, KKPAA do të ketë edhe takime tjera me mekanizma, institucione e persona relevant në funksion të çështjes së aftësisë së kufizuar.

5 Aktivitete sensibilizuese	1. Shenimi i dates 3 dhjetor si data nderkombetare per PAK-te, 2. Aktivitet sensibilizues në kuader të Javes se Rinisë në Kaçanik	Raportet, lista e pjesëmarrjes, fotografit etj	KKPAK	Shtator dhe Dhjetor	
6. Edukimi	1. Ligjerata me nxënësit e shkollave të mesme 2. Ligjerata për edukim shendetesor për PAK-te dhe familjarët e tyre	Raporte, lista e nënshkrimeve, fotografi	KKPAK	Maj dhe Qershor	
Promovimi i çështjes së aftësisë së kufizuar	1. Hapja e një faqe në rrjetet sociale 2. Prezenca e KKPAK në media dhe rrjetet sociale	Fotografi, postimet etj	KKPAK	Janar-Dhjetor	
7. Trajnimet;	1. Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme 2. Numeri i trajnimeve 3. Numeri i anëtarëve të trajnuar	Raportet, fotografit	KKPAK-organizatat e ndryshme trajnuese	Janar-Dhjetor	Kjo pjesë e aktivitetëve varet nga tregu dhe çmimi trajnimeve që ofrohen dhe mundësitë financiare të anëtarëve të KKPAK për të ndjekur këto trajnime.


 Kryesuesi i KKPAK-së Kaçanik
 Artan Mezraja



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr.060/01-39074/19
Kaçanik: 27.12.2019

Në bazë të nenit 55 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Draft Planit të Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 27 Dhjetor 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KOMITETIT PËR
KOMUNITETE PËR VITIN 2020


1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete, për vitin 2020, i propozuar nga Komiteti për Komunitete, me tekstin e mëtejme, Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020.
2. Në Planin e Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2020, janë paraqitur objektivat e këtij Komiteti, arsyeshmëria e tyre, adresimi, përkrahja e nevojshme dhe koha e implementimit të aktiviteteve.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është : Plani i Aktiviteteve të Komitetit për Komunitete për vitin 2020 01Nr. 060/01-39074/19, i përmbledhur në gjithsej, 4 faqe.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete do të kujdeset; Komiteti për Komunitete dhe organet tjera relevante të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti për Komunitete dhe Arkiva.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01/Nr 60/01-33074-----2019

PLANI I PUNËS I KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2020

Kaçanik, 2019

Komiteei për Komunitete



- Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale ,praktikave dhe aktiviteteve për ti siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve të komunës masat që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar ,shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor ,fetar dhe gjuhësor ,si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës .

Përbërja e Komitetit për Komunitete

Nr	Emri e mbiemri	Përfaqësimi	Telefoni	E-mail adresa
1	Lirije Luta	Anëtare e Kuvendit PDK Kryesuese e Komitetit për Komunitete	044/824-768	lirije.geli@ks-gov.net lira22@live.com
2	Nazife Krasniqi	Anëtare e Kuvendit LDK	044/ 693- 670	xifja62@hotmail.com nazife.krasniqi@rks-gov.net
3	Shemsedin Abazi	KLMDNJ	044/224-685	shabazi@live.com
4	Elmihane Krasniqi-Malsiu	Handikos	044/235- 717	handikoskaganik@hotmail.com
5	Hajredin Luta	Anëtarë i Kuvendit Kandidat i panvarur	044 /227- 595	Hajredin_luta@outlook.com
6	Kaltrina Tafili	Anëtare e Kuvendit LVV	045/271-880	Kaltrinatafili14gmail.com
7	Naim Hysa	Kryqi i Kuq	044/224-881	kacanic@rdcross-ks.org

Temat dhe Aktivitetet e Komitetit për Komunitete për vitin 2020

Nr.	Tema	Aktivitetet	Përtrahja e nevojëshme	Kalandari Kohor 2019
1.	1. Gjendja e vaksinimit të rregullt dhe sezonal 2. Furnizimit me barna esenciale në komunën e Kaçnikut	Vizitë zyres së vaksinimit në QKMF Vizitë barnatorës së QKMF-ës	Drejtoria e Shendetësisë Drejtori i QKMF-ës	Mars – Maj
2.	Strategjia për përbushjen e Planit të Komitetit për Komunitete	Vizitë në disa komuna fqinje, qëllimi për shkëmbimin e përvojave në mes të komunave	Institucionet Lokale -Zyra e Kryetarit	Qershor – Gusht
3.	Monitorimi lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarve të kthyer nga diaspora	Vizitë në zyrën për kthimin dhe adresimin Hulumtimi rreth statistikave	Institucionet Lokale dhe Qendrore	Korrik – Shtator
4.	Gjendja e arsimit nëpër Shkolla	Vizitë në QEAP “Agimi” Vizitë shollave fillore dhe të mesme, takim me kordinator .	Drejtoria e Arsimit Drejtor te Shkollave	Qershor- Shtator

5.	Monitorimi rreth të drejtave të qytetarëve të komunës së Kaçanikut	Takim me zyrtarin për të drejtat e njeriut dhe barzi gjinore	Institucionet Lokale dhe Qendrore	Korrik-Shtator
6.	Montorimi i Qendrave Rinore në Kaçanik	Takim me Kordinatorin për rini Takim me kryetarin e KRVL-ës Takim me Qendrën Rinore „Shtëpia e Shpresës	KRVL Kordinatori për rini	Mars-Dhjetor
7.	Monitorimi i Sportit në Komunën e Kaçanikut	Takim me përfaqësues të sportit	DAK Përfaqësues të Sportit	Mars-Dhjetor
8.	Rastet Sociale	Monitorimi i ndarjes së banimit Social	Drejtori i Qendrës për punë Sociale	Gusht -Dhjetor
9.	Ndarja e Grantëve dhe Subvencioneve për OJQ-të	Takim me OJQ-të Monitorimi i ndarjes së Grantëve	DAK-ja	Mars-Tetor

10.	Krijimi i Hapësirave për Parkingje	Takim me Drejtorin e Urbanizmit dhe Komandantin e Stacionit Policor	Drejtoria e Urbanizmit Stacioni Policor	Mars-Dhjetor
-----	------------------------------------	---	---	--------------

Vrejtje : Përveç aktiviteteve të parapara në planë të punës , temave të lartëcekura ne sipas nevojës mund të zhvillojmë edhe ndonjë aktivitet shtesë.

Grupi punues :

- 1.Elmi hane Krasniqi-Malsiu
- 2.Naim Hysa
- 3.Nazife Krasniqi
- 4.Hajredin Luta
- 5.Kaltrina Tafili
- 6.Shemседin Abazi
- 7.Lirije Luta

Kaçanik- Dhjetor,2019

Kryesuesja :Lirije Luta





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 104/02-39584/19
Kaçanik, 27.12.2019

Në bazë të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më 27 Dhjetor 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË
2020-2023

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Kaçanikut për vitet 2020-2023.
2. Në Planin e Veprimit për Transparencë si në pikën 1 të këtij vendimi, janë paraparë veprimet të cilat duhet t'i merr komuna me bërë publike aktivitetin e komunës në periudhën katër vjeçare, 2020-2023.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Plani i Veprimit për Transparencë 2020-2023, i përmbledhur në gjithsej 14 Faqe si në Lëndën: 01Nr. 104/02-39584/2019.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Më këtë Vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit të Komunës- përmes kësaj zyre njoftohen organet tjera relevante, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

I	Data	17.12.19	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02-39584	/.		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

2020-2023

Zyra për Informim

Përmbajtja

1. Mbledhje të hapura të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve.....	4
2. Përgatitja dhe publikimi i informatave nga mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve si dhe transmetimi i seancës së kuvendit përmes teleprezencës video ingjizimit.....	4
3. Takimet e Kryetarit me Publikun.....	4
4. Konsultimet me Publikun.....	5
5. Raportet/Informatat për media të Kryetarit dhe Drejtorive Komunale.....	5
6. Raportet/informatat për media të Kryesuesit	5
7. Takimet e Kryetarit me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë.....	5
8. E drejta e qasjes në dokumente publike.....	6
9. Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet.....	6
10. Publikimi i akteve komunale.....	7
11. Mirëmbajtja dhe freskimi i web faqes zyrtare dhe publikimin e Vjetarit të Komunës.....	7
12. Shfrytëzimi i rrjeteve sociale.....	7
13. Qasje e lehtë e qytetarëve në shërbimet digjitale.....	7
14. Prokurimi transparent.....	8
15. Transparenca në procedurat e punësimit.....	8
16. Plani i Veprimit.....	9

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton pjesëmarrje qytetare dhe vendimmarrje transparente. Komuna e Kaçanikut kujdeset maksimalisht që të përmbushë këto standarde, e vetëdijshme se vendimmarrja transparente e rrit besueshmërinë e publikut te qeverisja lokale.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.04/2018, për Transparencë në Komuna neni 15, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, propozon këtë Plan të Veprimit për Transparencë të Komunës.

Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është fuqizimi i transparencës së organeve të komunës për informim të qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit si dhe publikimin e dokumenteve të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Fushëveprimi

Ky dokument obligon komunën që të gjitha aktivitetet dhe dokumentet publike, të bëhen transparente dhe të jenë të qasshme për publikun sipas afateve të caktuara ligjore.

1. Mbledhje të hapura të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal të Kaçanikut dhe të Komiteteve të tij, janë të hapura për publikun. Ato paralajmërohen me kohë nga ana e sekretarisë së Kuvendit, ndërkaq nga ana e zyrtarëve për informim, në të njëjtën kohë publikohen në ueb faqen zyrtare dhe në faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut në rrjetin social Facebook. Mbledhjet janë të hapura për publikun.

2. Përgatitja dhe publikimi i informatave nga mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve si dhe transmetimi i seancës së kuvendit përmes teleprezencës dhe video ingjizimit

Pas përfundimit të mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve, Zyra për Informim është përgjegjëse që të përgatis informatën dhe publikojë në ueb faqe të Komunës, si dhe të publikoj teleprezencën dhe video ingjizimin e tërë seancës së kuvendit.

3. Takimet e Kryetarit me Publikun

Kryetari i Komunës së Kaçanikut mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm, ku mund të marrë pjesë secili qytetar, shoqëria civile dhe grupet e caktuara të interesit. Në këtë rrafsh, Zyra e Kryetarit, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme. Njoftimi duhet të bëhet në web faqen zyrtare si dhe në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës, sikur edhe në rrjetet sociale. Pas mbajtjes së takimeve të kryetarit, publikohet informata për media në web faqe, sikurse edhe procesverbali.

4. Konsultimet me Publikun

Komuna e Kaçanikut organizon konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, pronën komunale, planifikimin hapësinor, investimet, rregulloret e plane komunale, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera të përgjithshme, apo me interes të veçantë. Sekretaria e Kuvendit, përmes zyrtarit për komunikim me qytetarë, njofton publikun së paku dy javë para mbajtjes së konsultimeve publike: në web faqen zyrtare, si dhe në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës si dhe në rrjetët sociale. Pas mbajtjes së konsultimeve, publikohet informata për media në web faqe, sikurse edhe procesverbali.

5. Raportet/Informatat për media të Kryetarit dhe Drejtorive Komunale

Kryetari i Komunës së Kaçanikut dhe drejtorët e Drejtorive komunale përgatisin raportet/informatat për media të paktën dy herë brenda vitit, një në fund të gjashtëmujorit të parë dhe tjetri në përmbyllje të vitit kalendarik. Këto raporte publikohen nga Zyra për Informim Publik. Sipas nevojës, në rastet kur komuna ka diçka të rëndësishme për të ndarë me publikun, raportet mund të jenë edhe më të shpeshta. Të gjitha informatat publikohen në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të Komunës në rrjetin social Facebook.

6. Raportet/informatat për media të kryesuesit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut përgatit raport/informatë për media të paktën dy herë brenda vitit, edhe atë për gjashtëmujorin e parë dhe në fund të vitit kalendarik. Raportet publikohen në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të Komunës në rrjetin social Facebook.

7. Takimet e Kryetarit me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë

Kryetari i Komunës së Kaçanikut në kuadër të kompetencave të tij, realizon takime në formë debati me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë. Debatet e tilla i organizon Kabineti i Kryetarit, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme për pjesëmarrje të publikut. Njoftimi bëhet dy javë para ditës së mbajtjes së takimeve, në web faqen zyrtare të Komunës dhe faqen zyrtare në rrjetin social Facebook. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Kaçanikut cakton një ditë brenda javës për takime të rregullta me qytetarë. Shoqëria civile do të ketë qasje në procesin e identifikimit të nevojave të qytetarëve, në takimet publike, gjatë procesit të përpilimit të buxhetit.

8. E drejta e qasjes në dokumente publike

Për të qenë sa më transparent ndaj publikut, Komuna e Kaçanikut, përmes zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumentet publike, bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, të aprovuara nga organet e Komunës dhe i adreson ato në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike. Kërkesat për qasje në dokumente trajtohen nga cilido institucion që posedon dokumentin dhe mbikëqyrë informatën. Institucioni publik ndihmon parashtruesin e kërkesës për aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë, që të identifikojë dokumentin e kërkuar. Kërkesat për qasje në dokumente publike trajtohen në mënyrë të barabartë dhe shqyrtohen sipas afatit. Komuna është e obliguar që brenda shtatë ditëve, nga dita e pranimin të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar, ose të jap përgjigje me shkrim mbi arsyet e refuzimit të plotë apo të pjesshëm dhe informon parashtruesin për të drejtën e tij të mëtutjeshme. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike mund të vazhdohet deri në 15 ditë, nëse dokumenti publik kërkohet jashtë organeve të Komunës dhe nëse kërkohen disa dokumente publike. Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me shkrim ose në formë elektronike. Në rast se organet e komunës nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të fillojë procedurën, para institucionit të avokatit të popullit, apo institucioneve tjera publike, gjykatës kompetente në përputhje me ligjin në fuqi.

9. Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet

Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtojë kërkesë për Komunën e Kaçanikut, për realizimin e iniciativave qytetare dhe peticioneve për çështje që janë në përgjegjësi të organeve komunale. Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari, Drejtoria, Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë, jo më vonë se 15 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit. Kërkesa për iniciativa qytetare dhe peticione parashtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me shkrim. Kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet, shqyrtohen nga Komuna e Kaçanikut brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Komuna u ofron mbështetje OJQ-ve për realizimin e aktiviteteve me interes të përgjithshëm, ofron garanci për përfshirjen e qytetarëve në komisione të ndryshme si dhe informon qytetarët për kërkesat e parashtruara.

10. Publikimi i akteve komunale

Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit Komunal të Kaçanikut, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit, bëhen publike dhe të qasshme për publikun, pas vlerësimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Të gjitha aktet nënligjore dhe dokumentet tjera publike publikohen në web faqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut edhe atë 15 ditë pas regjistrimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërkaq dokumentet tjera publike, publikohen pas hyrjes në fuqi. Për dërgimin e akteve është përgjegjëse Sekretaria e Kuvendit.

11. Mirëmbajtja dhe freskimi i web faqes zyrtare dhe publikimin e Vjetarit të Komunës

Web faqja zyrtare e Komunës së Kaçanikut mirëmbahet dhe freskohet me lajme e informacione nga aktivitetet e përditshme të ekzekutivit dhe vendimmarrjes, si dhe me dokumente publike, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015. Përgjegjës për këtë është Zyra për Informim dhe zyra e IT-së e Komunës së Kaçanikut.

12. Shfrytëzimi i rrjeteve sociale

Komuna e Kaçanikut ka të hapur faqen zyrtare edhe në rrjetin social Facebook, në të cilën publikohen të gjitha informatat e ekzekutivit dhe vendimmarrësve komunalë, sikurse edhe materialet tjera. Përgjegjëse për këtë faqe është Zyra për Informim.

13. Qasje e lehtë e qytetarëve në shërbimet digjitale

Komuna e Kaçanikut, për të lehtësuar qasjen e qytetarëve në shërbime, ka mundësuar aplikimin online për certifikatat e gjendjes civile, në web faqen zyrtare të Komunës. Poashtu për të lehtësuar procedurat janë publikuar edhe disa udhëzues për dokumente të ndryshme të gjendjes civile, kadastrit etj.



14. Prokurimi transparent

Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Departamenti i Prokurimit i dërgon me kohë të gjitha njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftimet për konkurse të projektimit, njoftimet për anulim dhe njoftimet për vazhdim të afatit. Përgjegjës për publikim të tyre në web faqe është Departamenti i Prokurimit, Zyra për Informim dhe IT- e Komunës.

15. Transparenca në procedurat e punësimit

Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Zyra e Personelit, është përgjegjëse për publikim në web faqe dhe në media të shkruara ose elektronike të konkurseve, njoftimeve për përzgjedhjen e kandidatëve, njoftimeve për anulim të konkurseve, rishpalljen apo vazhdimin e konkurseve, avancimet brenda institucionit si dhe aplikacionet për punësim. Kjo realizohet në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

16. Plani i Veprimit

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteteve të organeve të komunës.
1	Mbledhje të hapura të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve	Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve në: Web faqen zyrtare Në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës Rrjetet sociale	Sekretaria e Kuvendit përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjeve për mbledhjet e kuvendit dhe tri ditë për mbledhjet e komiteteve	Salla e Kuvendit Komunal / Komiteteve	Shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjeve për mbledhjet e kuvendit dhe tri ditë për mbledhjet e komiteteve
2	Përgatitja dhe publikimi i informatave nga mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve	Përgatitja e informatave pas çdo mbledhje të Kuvendit dhe komiteteve për mediat e shkruara dhe elektronike si dhe rrjetet sociale	Zyra për Informim		
3	Takimet e kryetarit me publikun	Kryetari i Komunës së Kaçanikut mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm	Zyra e Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në web faqen zyrtare, rrjete sociale dhe në vendet më të frekuentuara	Salla e kuvendit	Njoftimi 2 javë para mbajtjes

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës.
4	Konsultimet me publikun	Komuna e Kaçanikut organizon konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal	brenda territorit të Komunës	Kuvendi komunal	Njoftimi 2 javë para mbajtjes
5	1. Raportet/Informatat për media të Kryetarit dhe drejtorive Komunale	Kryetari i Komunës së Kaçanikut dhe drejtorët e Drejtorive komunale publikon raportet/informatat, të paktën dy herë brenda vitit.	Zyra për Informim Publik publikon raportet/informatat në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të Komunës në rrjetin social Facebook.		
6	Raportet/Informatat për media të Kryesuesit	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut publikon raportin/informatën të paktën dy herë brenda vitit	Zyra e Kuvendit përgatit raportin/informatën dhe i përcjell zyrës së informimit për publikim në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të komunës		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktivitetet e komunës	Vendi i mbajtjes së aktivitetit	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktivitetet e organeve të komunës.
7	Takimet e Kryetarit me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë	Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në kuadër të kompetencave të tij, realizon takime në formë debati me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë	në rrjetin social Facebook	Zyra e Kryetarit ose salla tjera alternative	
8	E drejta e qasjes në dokumente publike	Për të qenë sa më transparent ndaj publikut, Komuna e Kaçanikut, bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, të aprovuara nga organet e Komunës dhe i adreson ato në pajtueshmëri me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet publike		7-15 ditë
9	Kërkesat për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet	Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtojë kërkesë në Komunën e Kaçanikut, për realizimin e iniciativave qytetare dhe peticioneve për	Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari, Drejtorja, Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë, jo më vonë se 15 ditë nga dita e		15 ditë

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteteve të organeve komunës.
		çështje që janë në përgjegjësi të organeve komunale.	shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.		
10	Publikimi i akteve komunale	Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit Komunal të Kaçanikut publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun	Sekretaria e Kuvendit përmes Zyrës për Informim Publik dhe njësia e IT-së, publikon aktet komunale në web faqen zyrtare		
11	Publikimi i të gjitha raporteve, vendimeve, rregulloreve, buxhetit komunal, projekteve kapitale, projekteve të planifikuara, tenderëve, etj. të zyrës së kryetarit, dhe shërbimeve tjera të komunës	Të gjitha raportet, vendimet, buxheti komunal, projektet kapitale, projektet e planifikuara, tenderët etj. nga zyra e kryetarit dhe shërbimet e tjera të komunës do të bëhen publike dhe të qasshme për qytetarët	Kabineti i Kryetarit përmes Zyrës për Informim Publik dhe Njësia e IT-së publikon aktet komunale në web faqen zyrtare		
12	Mirëmbajtja dhe freskimi i web faqes zyrtare	Web faqja zyrtare e Komunës së Kaçanikut freskohet me lajme e informacione nga aktivitetet e përditshme të ekzekutivit dhe vendimarrjes,	Përgjegjëse për këtë është Zyra për Informim e Komunës së Kaçanikut.		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteteve të organeve të komunës.
		si dhe materiale tjera publike			
13	Transmetimi i seancave të kuvendit komunal	Transmetimi i seancës së kuvendit komunal përmes video ingjizimit, i cili më pas transmetohet në faqen zyrtare të Komunës si dhe në rrjetin social	Përgjegjëse për këtë është Njësia e IT-së e Komunës së Kaçanikut.		
14	Shfrytëzimi i rrjeteve sociale	Komuna e Kaçanikut ka të hapur faqen zyrtare në rrjetin social Facebook, ku publikohen të gjitha informatat e ekzekutivit dhe vendimmarrësve sikurse edhe dokumente të tjera.	Përgjegjëse për këtë faqe është Zyra për Informim Publik dhe njësia e IT-së		
15	Qasje e lehtë e qytetarëve në shërbimet digjitale	Komuna e Kaçanikut ka mundësuar aplikimin online për certifikatat e gjendjes civile, në web faqen zyrtare të Komunës. Poashtu për të lehtësuar proceduarat janë publikuar edhe disa udhëzues për dokumente të ndryshme të gjendjes civile, kadastrit etj.	Përgjegjëse është Drejtoria e Administratës përmes Zyrës për Informim Publik dhe Njësia e IT-së		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktivitetet e komunës	Vendi i mbajtjes së aktivitetit	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktivitetet e organeve të komunës.
17	Prokurimi transparent	Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Departamenti i Prokurimit i dërgon me kohë të gjitha njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftimet për konkurse të projektimit dhe njoftimet për vazhdim të afatit.	Përgjegjës për publikim të tyre në web faqe është Departamenti i Prokurimit, Zyra për Informim njësia e IT-së e komunës.	Sipas afateve ligjore	Sipas afateve ligjore
18	Transparenca në procedurat e punësimit	Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Zyra e Personelit është përgjegjëse për publikim në web faqe dhe media të shkruara ose elektronike të konkurseve, njoftimeve për përzgjedhjen e kandidatëve, njoftimeve për anulim të konkurseve, rishpalljen apo vazhdimin e afateve, avancimet brenda institucionit si dhe aplikacionet për punësim.	Zyra e Personelit në bashkëpunim me Zyrën për Informim Publik dhe njësia e IT-së	Sipas afateve ligjore	Sipas afateve ligjore



Kaçanik

Kryetari Besim Haxhi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr.07-104/02-39515/19
Kaçanik, 16.12.2019

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008) Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L—111, Vendimit Nr. Prot. 3848 datë 10.12.2018 të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra, nenit 6 të Statutit të Komunës, duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.07-104/02-39515/19, për Ndryshimin e Statusit të KRU “Bifurkacioni” në të cilën Komuna e Kaçanikut është aksionar, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 Dhjetor 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT SË KRU “BIFURKACIONI” NGA NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE NË NDËRMARRJE PUBLIKE QENDRORE

1. Me këtë Vendim miratohet, Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës 01Nr. 07-104/02-39515/19 prej datës 16.12.2019- Për Ndryshimi i Statusit të KRU “Bifurkacioni” nga Ndërmarrje Publike Lokale në Ndërmarrje Publike Qendrore sipas Vendimit të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra me Nr. Prot. 3848 datë 10.12.2018.
2. Arsyeshmëria e këtij Vendimi është dhënë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë e Komunës Kaçanik dhe e njëjta iu ka bashkangjitur Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, bashkëngjitur edhe këtij vendimi.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Rekomandimet e grupit punues për zbatimin e vendimit për Ndryshimi i Statusit të KRU “Bifurkacioni” nga Ndërmarrje Publike Lokale në Ndërmarrje Publike Qendrore, Vendimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për formimin e grupit punues i datës 10.12.2018 për veprimet e nevojshme për ndryshimet e statusit të ndërmarrjes si dhe Vendimi i Këshillit Ndërmnistror për ujërat i datës 15 Nëntor 2019.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Autoriteti Rregullativ për Shërbime të Ujit dhe KRU “Bifurkacioni”-Ferizaj.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë(përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante), Drejtoria e Ekonomisë Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr. 104/02-39515/19
Kaçanik, 16.12.2019

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L—111, Vendimit Nr. Prot. 3848 datë 10.12.2018 të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra, në cilësi të Kryetarit të Komunës, si aksionar në KRU “Bifurkacioni”, bazuar në rekomandimet e grupit punues nxjerr këtë:

Propozim

Që Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e radhës më _____ 2019, të shqyrton dhe aprovon duke e proceduar për procedura të mëtejme në Kuvend të Komunës,

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT SË KRU “BIFURKACIONI” NGA NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE NË NDËRMARRJE PUBLIKE QENDRORE

I

Me këtë Vendim miratohet ndryshimi i statusit së KRU “Bifurkacioni” nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore sipas Vendimit të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra me Nr. Prot. 3848 datë 10.12.2018.

II

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Autoriteti Rregullativ për Sherbime të Ujit dhe KRU “Bifurkacioni”-Ferizaj.

III

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.



Arsyetim

Këshilli Ndërmator për Ujëra brenda kompetencave të përcaktuara me ligj, në mbledhjen e datës 15.11.2018, ka nxjerr vendim dhe ka udhëzuar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit që të filloj procesin e integritetit të komunave të Hanit të Elezit dhe Shtërpces në KRU "Bifurkacioni" dhe t'i paraqesin këtij organi propozim-vendimin për ndryshimin e statusit të Kompanisë Rajonale të Ujësjetllësit "Bifurkacioni" nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore.

Grupi punues i themeluar me vendimin e Ministrisë së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nr. 1632 të datës 8.07.2019 për zbatimin e vendimit të Këshillit Ndërmator për Ujëra nr. 3848 të datës 10.12.2018, për ndryshimin e statusit të KRU Bifurkacioni nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2019 ka mbajtur 3 takime (më 24 korrik, 20 gusht dhe 6 dhjetor) në të cilat takime ka diskutuar veprimet dhe modalitetet specifike për zbatimin e vendimit të lartëpërmendur të Këshillit Ndërmator për Ujëra. Bazuar në këto diskutime, për zbatimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndryshimin e statusit të KRU Bifurkacioni nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore, grupi punues nxjerr këto:

REKOMANDIME

1. Komuna e Ferizajt dhe komuna e Kaçanikut, në takimet e asambleve komunale respektive deri në fund të vitit 2019, ta diskutojnë dhe të marrin vendim për ndryshimin statusit të KRU Bifurkacioni nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore.
2. Pas marrjes së vendimit nga asambletë komunale të Ferizajt dhe Kaçanikut, KRU Bifurkacioni me mbështetjen e Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, të ndërmarrin veprimet e duhura për ndryshimin e statutit të KRU Bifurkacioni dhe regjistrimin e kësaj Kompanie në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve si ndërmarrje publike qendrore.
3. Bordi aktual i drejtorëve të KRU Bifurkacioni, pas ndryshimit të statusit, të plotësohet edhe me dy anëtar të rinj: një nga komuna e Hanit të Elezit dhe një nga komuna e Shtërpces.
4. Të gjitha borxhet dhe detyrimet e papaguara financiare që mund t'i këtë KRU Bifurkacioni janë përgjegjësi e plotë e KRU Bifurkacioni në pajtim me nenin 39 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
5. Të gjitha pronat në të cilat janë ndërtuar objektet e sistemeve të shërbimeve të ujit apo pronat e paluajtshme të cilat janë përcaktuar si zona e parë e mbrojtjes së një burimi i cili shfrytëzohet për shërbimet e ujit, e të cilat nuk janë në pronësi të saj, KRU Bifurkacioni ka drejtë t'i shfrytëzojë por pronësia mbetet e komunës.
6. Struktura organizative e KRU Bifurkacioni të përshtatet në pajtim me modelin e rekomanduar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik i cili model vlen për të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujit.

Drejtori i DSHPE-së
Ramadush Osmani





Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja – Ministry of Economic Development

R E K O M A N D I M E T
E GRUPIT PUNUES PËR ZBATIMIN E VENDIMIT
PËR NDRYSHIMIN E STATUSIT TË KRU BIFURKACIONI
NGA NDËRMARRJE PUBLIKE LOKALE NË NDËRMARRJE PUBLIKE QENDRORE

13 dhjetor 2019

Grupi punues i themeluar me vendimin e Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nr. 1632 të datës 8.07.2019 për zbatimin e vendimit të Këshillit Ndërmintor për Ujëra nr. 3848 të datës 10.12.2018, për ndryshimin e statusit të KRU Bifurkacioni nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2019 ka mbajtur 3 takime (më 24 korrik, 20 gusht dhe 6 dhjetor) në të cilat takime ka diskutuar veprimet dhe modalitetet specifike për zbatimin e vendimit të lartëpërmendur të Këshillit Ndërmintor për Ujëra. Bazuar në këto diskutime, për zbatimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndryshimin e statusit të KRU Bifurkacioni nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore, grupi punues nxjerr këto:

REKOMANDIME

1. Komuna e Ferizajt dhe komuna e Kaçanikut, në takimet e asambleve komunale respektive deri në fund të vitit 2019, ta diskutojnë dhe të marrin vendim për ndryshimin statusit të KRU Bifurkacioni nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore.
2. Pas marrjes së vendimit nga asambletë komunale të Ferizajt dhe Kaçanikut, KRU Bifurkacioni me mbështetjen e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, të ndërmarrin veprimet e duhura për ndryshimin e statutit të KRU Bifurkacioni dhe regjistrimin e kësaj Kompanie në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve si ndërmarrje publike qendrore.
3. Bordi aktual i drejtorëve të KRU Bifurkacioni, pas ndryshimit të statusit, të plotësohet edhe me dy anëtar të rinj: një nga komuna e Hanit të Elezit dhe një nga komuna e Shtërpçës.
4. Të gjitha borxhet dhe detyrimet e papaguara financiare që mund t'i këtë KRU Bifurkacioni janë përgjegjësi e plotë e KRU Bifurkacioni në pajtim me nenin 39 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
5. Të gjitha pronat në të cilat janë ndërtuar objektet e sistemeve të shërbimeve të ujit apo pronat e paluajtshme të cilat janë përcaktuar si zona e parë e mbrojtjes së një burimi i cili shfrytëzohet për shërbimet e ujit, e të cilat nuk janë në pronësi të saj, KRU Bifurkacioni ka drejtë t'i shfrytëzojë por pronësia mbetet e komunës.
6. Struktura organizative e KRU Bifurkacioni të përshtatet në pajtim me modelin e rekomanduar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik i cili model vlen për të gjitha Kompanitë Rajonale të Ujit.

Prishtinë, 13.12.2019

Anëtarët e Grupit Punues:

1. Adem Ahmetaj, NJPM e NP/MZHE – kryesues
2. Mërgime Berisha, MZHE – anëtare
3. Afrim Lajçi, KNMU – anëtar
4. Arben Halili, komuna e Ferizajt – anëtar
5. Ramadush Osmani, komuna e Kaçanikut – anëtar
6. Kujtim Dërmjani, komuna e Hanit të Elezit – anëtar
7. Sinisa Buduric, komuna e Shtërpçës – anëtar



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Nr. i Org. Org. Jedin Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	1632
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	1	Data Datum Date	08.07.19
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbështetje të Nenit 10 dhe 11 të Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ Nr.7/01 mars 2019), Ligjin Nr. 3/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ Nr. 31 /15 Qershor 2008) Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ. Nr. 13/30 maj 2012), Ligji Nr. 05/L -009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111/ (GZ. Nr.10/07 maj 2015) dhe Nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Vendimit Nr.Prot.3848 datë 10.12.2018 të Këshillit Ndërmnistror për Ujërat, nxjerr:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për ndryshimin e statusit të Kompanisë Rajonale e Ujësjetllësit Bifurkacioni/KRU Bifurkacioni nga ndërmarrja publike lokale në ndërmarrje publike qendrore.

2. Grupi Punues përbëhet nga:

- 2.1. Një përfaqësues, NJMNP/MZHE - Kryesues;
- 2.2. Një përfaqësues, MZHE - Anëtar
- 2.3. Një përfaqësues, Sekretariati i Këshillit Ndërmnistror për Ujëra -Anëtar;
- 2.4. Një përfaqësues, Komuna e Ferizajt – Anëtar;
- 2.5. Një përfaqësues, Komuna e Kaçanikut - Anëtar;
- 2.6. Një përfaqësues, Komuna e Hani i Elezit - Anëtar;
- 2.7. Një përfaqësues, Komuna e Shtërpçës -Anëtar.

3. Grupi Punues ka për detyrë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për ndryshimin e statusit të KRU Bifurkacioni nga ndërmarrja publike lokale në ndërmarrje publike qendrore, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Grupi Punues
- Arkivës

Prishtinë, 08.07.2019

Valdrin Lluka
Ministër i Zhvillimit Ekonomik

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КООСОВА QEVERIA E KOSOVËS - ВЛАДА КОСОВА / GOVERNMENT OF KOSOVO ЗБИРАНИШТА ИЛИ РЕПУБЛИКА - ПРЕТКАН ДИ ДИРЕКТОРИ СЕКТОРИ АРХИВИС - СЕКТОР АРХИВЕ - ARCHIVE SECTION	
Numri i Dokumentit Doc. No. 01	Nr. i Dokumentit Doc. No. 3848
Nr. i Dokumentit Doc. No. 3	Data Dated: 10 / 12 / 2018
Prekshë / a	



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Këshilli Ndërmintor për Ujërat - Međumintarski odbor za vode - Inter-Ministerial Water Council

Nr. KNMU/K/04/2018

Datë: 7. 12. 2018

Në mbështetje të nenit 15 dhe 17 të Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, dhe nenit 11 të Rregullores QRK nr. 11/2014 për Punën e Këshillit Ndër-Mintor për Ujërat, Këshilli Ndër-Mintor për Ujërat në mbledhjen e datës 15 nëntor 2018, nxjerr:

VENDIM

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit udhëzohen të fillojnë procesin e integritetit të komunave të Hanit të Elcizit dhe Shtërpces në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Bifurkacioni" dhe deri në fund të vitit 2018 të paraqesin në Këshillin Ndërmintor për Ndërmarrjet Publike propozim-vendimin për ndryshimin e statusit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Bifurkacioni nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore.
2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit udhëzohen të dorëzojnë deri në fund të vitit 2018 në Këshillin Ndër-Mintor për Ujërat një raport të ecures së zbatimit të vendimit nr. 06/11 për konsolidimin e sektorit të shërbimeve të ujit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Kryesues i Këshillit Ndër-Mintor për Ujëra

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Ndër-Mintor për Ujërat;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit;
- Arkivit të Qeverisë.




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



1	Data	16.12.2019	Vendi	KAÇANIK
2	Org.		Numri	07
3			Shtojcë	104/02-39515 -1.



Kuvendi i Komunës
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATË/A:	16. 12. 2019
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kuvendit Komunal Kemajl MËRSELI, kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Besim ILAZI, kryetar i komunës
NGA/OD/FROM :	Ramadush OSMANI, drejtor i DSHPE-së
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim-vendimi për ndryshimin e statusit aktual të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Bifurkacioni" SH.A.

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese zyrtare ju dorëzojmë **Propozim-vendimi për ndryshimin e statusit të KRU "Bifurkacioni"** nga ndërmarrje publike lokale në ndërmarrje publike qendrore për shqyrtim në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe procedim të metejmë, si pikë e rendit të ditës në seancën e radhës së kuvendit komunal.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MZHE-së	
Përmes:		
Nga:	Rozafa Ukimeraj Sekretare e Përgjithshme në MAPL	Datë: 21/01/2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerçini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	Nr.020-25/2
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

E nderuara Kryesuese,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut Nr.04/02-35515/19 i datës 16.12.2019 për ndryshimin e statusit të KRU "Bifurkicioni" nga ndërmarrja publike lokale në ndërmarrje publike i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria

Vlada-Government

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

01/3 33
20.01.20
20.01.2020
000-23/2

DATA	16.01.2020
PËR/ZA/TO:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme MAPL
CC:	Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm MZHE
PËRMES/PREKO THROUGH:	
NGA/OD FROM:	Shugart Musliu, Drejtor i NJPMNP-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kyçesë për vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit të Komunës së Kaçanikut

E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të nënshkruara me ligjin bazik dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përcaktimet Administrative të Zyrtë të Kryeministrit dhe Ministrive, NJPMNP MZHE ka pritur për shqyrtim aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut Nr.04/02-35515.19 i datës 16.12.2019 për ndryshimin e e statusit të KRU "Bikurfigjori" nga ndërmarrja Publike Lokale në Ndërmarrje Publike, i miratuar nga Kuvendi i Komunitetit të Kaçanikut nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Ligji nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike, nenin 23 riformulon listën e ndërmarrjeve publike të ligjit bazik dhe Kompania Rajonale e Ujësjellësit Bifurkacioni sh.A. Ferizaj renditet në Ndërmarrje publike lokale me, Njësia Operative Ferizaj, Ferizaj 85.3% dhe Njësia Operative Kaçanik, Kaçaniku 14.7%.

Mbështetur në vendimin nr.06/11 për konsolidimin e sektorit të shërbimeve të ujit dhe vendimin e Komisionit Ndërmarrësor për Ujëra nr. KNMU/K/04/2018 të datës 07.12.2018 nënshkruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, obligohen aktet e përfshirë që të punojnë në ndryshimin e statusit të KRU Bifurkacioni nga Ndërmarrja Publike Lokale në Ndërmarrje Publike Qendrore, vendime këto të cilat janë në përputhje me ligjin bazik.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me aktet në fuqi dhe si i tillë mund të

prodhojë efekte juridike. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 Nr. 08-322/01-39425/19
Kaçanik, 27.12.2019

Në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse-dru për ngrohje me masën drusore të konfiskuar për vitin 2019, të Propozim Vendimit të DBPZHR 08Nr. 322/01-39425/19 prej datës 16.12.2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 27 Dhjetor 2019, mori këtë:

VENDIM
PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR-
SHKOLLAVE TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara 95 metër hapësinore (mh) në vitin 2019 që ndodhen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, pjesa që i takojnë komunës, t'iu ndahen atyre shkollave të komunës, të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë masë drusore.

2. Obligohet drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, të bëjë mbikëqyrjen e shpërndarjes së masës drusore që gjendet në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset; drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë, si dhe Drejtoria për Arsimit dhe Kulturë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
3. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës: dhe
4. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural
dhe Pylltari

08 Nr.

322/01-39425/10

Kaçanik, 16.12.2019

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë e Komunës së Kaçanikut, duke u bazuar në nenin 62 pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës me qëllim të furnizimit të shkollave me lëndë djegëse – dru për ngrohje, me masën drusore të konfiskuar për vitin 2019, që ndodhen në Autoparkun e Invalidëve të Luftës.

PROPOZON

Që Kuvendi i Komunës lidhur me masën drusore të konfiskuar për vitin 2019 të merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR - SHKOLLAVE

I.

Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara në vitin 2019, që ndodhen në Autoparkun Invalidëve të luftës, atyre shkollave të komunës të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë masë drusore.

II.

Obligohet DBZHRP që të bëjë mbikëqyrjen e shpërndarjes së masës drusore që gjenden në Autoparkun e Shoqatës Invalidëve të Luftës.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë.

IV.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e marrjes.

ARSYETIM

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë duke pasë parasyshë kërkesat e mëdha të shkollave për masë drusore për ngrohje, shpenzimet e larta që po krijohen me rastin e blerjes së masës drusore për furnizim të shkollave si dhe nevojës për kursim të buxhetit të Komunës, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë propozon që të vendoset si në dispozitiv të këtij Propozozim Vendimi, për ndarjen e masës drusore të konfiskuar 95(mh) metër hapsinore, sipas marveshjes me shoqatën e Invalidëve të Luftës (50% Komunës 50% SHIL-ës), që janë të vendosura në Autoparkun e SHIL-ës.

Drejtori i DBZHRP

Fatmir Loku





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01. Nr. 941/01-39854/2019
Kaçanik, 27.12.2019

Në bazë të nenit 12, 14.2(d) lidhur me nenin 14.1 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 24 dhe 25 pika 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 –Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2019), të nenit 21 dhe 50.1 të Ligjit Nr. 05/L-01 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016), duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01. Nr. 941/01-39854/2019, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me. 27 Dhjetor 2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR KORIGJIMIN E NJË GABIMI TEKNIK TË VENDIMIT 01Nr. 941/01-34155/2019 TË DATËS 31.10.2019

1. Me këtë Vendim bëhet korigjimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 941/01-34155/2019 i datës 31.10.2019 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Razim (Bedri)Palloshi nga f. Biçec,
2. Korigjimet bëhen të emërtimi i Vendimit dhe të pika 2 e paragrafit 2.2, si vijon:
 1. Të emërtimi i vendimit pas fjalës parcelat kadastrale hiqet pasuesi, 00091-1 dhe shtohet pasuesi, 00091-2.
 2. Të pika 2, e paragrafit 2.2 Parcela Kadastrale, ,hiqet pasuesi, Nr.00091-1 dhe shtohet pasuesi, Nr.00091-2.
3. Pjesët tjera të tekstit të Vendimit, mbetën të pandryshuara.
4. Ky Vendim e korigjon Vendimin e Kuvendit të Komunës 01Nr. 941/01-34155/2019 i datës 31.10.2019. dhe i njëjti është pjesë përbërëse e tij.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Urbanizimit Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevantë);
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Skupština Opština
Municipality of Assembly

01-Nr 941/01-3989 2019
Kaçanik, 20.12 /2019

Në bazë të nenit 58 ,shkronja h e Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës" nr.28/15 qershor 2008), të nenit 24 dhe 25 paragrafi 1 ,pika 3.1 I Ligjit nr.06/L- 092 për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës të nenit 21 të ,nenit 50 të Ligjit për procedurën administrative ,nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut , në cilësi të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut,

PROPOZOJ

I.Kuvendit të Komunës të bëjë korigjimin e Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të z.Razim Bedri Palloshi nga fsh.Biçec Vendimi 01.Nr.941/01-34155/2019 i datës 31.10.2012 dhe ate parcela kadastrale nr.00091-2 dhe paragrafi II, pika 2 pas,fjalës nr.00091-1 duhet të jet nr.00091-2.

II..Ky propozim Vendim hyn në fuqi pas miratimit.

Arsyetim

Drejtoria për Urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit duke shqyrtuar Vendimin për Këmbimin e pronës palujtshme të Komunës me pronën e palujtshme private të pronarit Razim Bedri Palloshi nga f.Biçec është vërtetuar se gjat përpunimit të dhënave në regjistrin e të drejtave të pronës së palujtshme si është bërë gabim teknik i parcelës kadastrale nr.00091-1 e cila duhet të bëhet parcela kadastrale nr.00091-2 për Z.K Nikaj në mënyrë që të bëhet regjistrimi i pronës së palujtshme në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Palujtshme për Z.K Nikaj, andaj ky organ duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi i propozon që i njeiti të miratohet .



Kryetari
Z. Besim Hazi



Drejtori
Ukshin Çallaku



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01. Nr. 941/01-34155/2019
Kaçanik, 31.10.2019

Në bazë të nenit 12, 14.2(d) lidhur me nenin 14.1 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 24 dhe 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 –Për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2019),të nenit 6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me, 31 Tetor 2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, P.K. NR. 00968-2 ME PRONËN E PALUAJTSHME PRIVATE, PARCELAT KADASTRALE : 00091-1 DHE 00092-2 NË EMËR TË RAZIM PALLOSHI NGA F. BIÇEC

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës 01Nr. 941/01-34155/2019 i datës 22.10.2019- për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Razim(Bedri) Palloshi nga f. Biçec.
2. Këmbimi i pronës së paluajtshme i theksuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, bëhet në mes të:
 - 2.1. Pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, Parcelës kadastrale **Nr. 00968-2** në sipërfaqe **989 m2**, me kulturë, rrugë e pa kategorizuar, në emër të P.Sh. Rrugë publike dhe e pa kategorizuar, Zona Kadastrale Nikaj, me Numër të lëndës, 941/01-33591/2019 të datës 15.10.2019 ; me
 - 2.2. Pronës së paluajtshme në pronësi private, Parcelës kadastrale **Nr. 00091-1** me sipërfaqe **781 m2**, me kulturë, kullosë e klasës 3 (Tretë) dhe Parcelën Kadastrale Nr. **00092-2** në sipërfaqe **208 m2**, me kulturë oborr, Zona Kadastrale Nikaj, e cila pronë evidentohet në emër të Razim (Bedri) Palloshi nga f.. Biçec, Certifikata e pronësisë me numër të lëndës 941/01-33593/2019 të datës 15.10.2019.
3. Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelave të tokës me pronarin e cekur si në këtë vendim, është bërë në kufijtë kadastral me pronën e Komunës për të cilën kërkohet këmbimi pasi që në pronën private veç është ndërtuar rruga Biçec-Nikaj. Magjistrallja Kaçanik-Ferizaj para shumë viteve.
4. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas dispozitave ligjore të ligjeve në fuqi, t'i zhvilloj procedurat e nevojshme të për këmbimin e pronës së përcaktuar në pikat e këtij vendimi.



5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Certifikatat me numër të lëndës: 941/01-33591/2019 e datës 15.10.2019 dhe Certifikata e pronës me numër të lëndës: 941/01-33593/2019 e datës 15.10.20129 për pronat që këmbehen dhe Situacioni.
7. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Urbanizimit Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevantë);
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 15/11/2019 Nr.020-1131
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01.nr.941/04-34155/2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës P.K.Nr.00968-2 me pronën e paluajtshme private parcelat kadastrale 00091-1 dhe 00092-2 në emër të Ramiz Palloshit nga Biçeci.
I miratuar më datë: 31.10.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.11.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Besim Ilazi, gradonačelnik opštine Kačanik Kemal Mërseli, predsedavajući Skupštine opštine Kačanik	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština / MALS	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 15.11.2019. Br. 020/1131
Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
Službenik-ca za izradu pravne procene:	Gezim Sahiti, službenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kačanik.	
Vrsta akata:	Odluka skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akata opština kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01.br.941/04-34155/2019, o razmeni nepokretne opštinske impovine P.K.br.00968-2 sa nepokretnom privatnom imovinom katastralnih parcela br. 00091-1 i 00092-2 na ime Ramiza Palošija iz sela Bičeci.

Usvojena dana, 31.10.2019. godine

Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 07.11.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenih akata opštine, procenjuje da su opštinski akti u saglasnosti za odredbama zakonodavstva na snazi.
Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS /KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917064-00968-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	941/01-33591/2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	15.10.2019 - 11:47
Komuna / Opština / Municipality:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917064-00968-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushvena Imovina / Socially owned Land		50413			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
DUSHKAJA/DUSHKAJA/DUSHKAJA		DUSHKAJA		

LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Pakategor/Nekategorisani Put/UncategorizedRoad		50413

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	P.SH. RRUGËT PUBLIKE DHE TË PAKATEGORIZUARA	KCID0900349	KAÇANIK / KAÇANIK / KAÇANIK /		EMIN DURAKU	1/1		



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : PALLOSHI RAZIM


Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	941/01-33593/2019
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	15.10.2019 - 11:45
Komuna / Opština / Municipality:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACIO OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
PALLOSHI	RAZIM	BEDRI	Mashkull / Musko / Male	KCID0906565	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
BIÇEC / BIÇEC / BIÇEC			BIÇEC	




SHKËMBIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësiesë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br./Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i kualtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna klasa Kultura-klasa upotreba/ Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917064-00091-0	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land /		DUSHKAJA SHPAT / DUSHKAJA SHPAT / DUSHKAJA SHPAT	390	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / /	1 / 1	Posëdim individual / Individualna Drzavina / single possessor	23.05.2017
P-70917064-00092-0	Kaçanik / Kačanik / Kačanik	NIKAJ / NIKAJ / NIKAJ	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna imovina Privately owned Land /		DUSHKAJA SHPAT / DUSHKAJA SHPAT / DUSHKAJA SHPAT	414	Tokë Ndërtimore - Shitëpi-Ndërtëse - / Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinosko zemljište - Kuca- Zgrada - / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - BackYard - / /	1 / 1	Posëdim individual / Individualna Drzavina / single possessor	23.05.2017

Propozimi për shkëmbimin e pronave të paluajtshme në zonën kadastrale Nikaj.

Nr.	Y	X	Z
1	7519171.054	4679881.350	0
2	7519179.289	4679836.917	0
3	7519186.658	4679840.710	0
4	7519186.983	4679866.395	0
5	7519182.975	4679886.334	0
6	7519186.984	4679884.600	0
7	7519163.469	4679936.621	0
8	7519173.548	4679938.895	0
9	7519174.089	4679934.669	0
10	7519155.017	4679966.965	0
11	7519159.134	4679952.768	0
12	7519151.766	4679980.512	0
13	7519146.265	4679980.944	0
14	7519149.538	4679957.888	0
15	7519157.258	4679916.432	0
16	7519162.151	4679894.816	0
17	7519169.962	4679851.906	0
18	7519176.367	4679852.682	0
19	7519167.391	4679908.043	0
20	7519172.360	4679913.700	0
21	7519177.863	4679920.015	0



Parcelës kadastrale 91-0 gjatë procesit të ndarjes ju mirret sipërfaqe 781m² me numër të ri 91-2 dhe i mbetet sipërfaqe 82m² me numër të ri kadastral 91-1 pronarit të vjetër.

Parcelës kadastrale 92-0 gjatë procesit të ndarjes ju mirret sipërfaqe 208m² me numër të ri 92-2 dhe i mbetet sipërfaqe 187m² me numër të ri kadastral 92-1 pronarit të vjetër.

Parcelës kadastrale 968-0 gjatë procesit të ndarjes ju mirret sipërfaqe 989m² me numër të ri 968-2 dhe i mbetet sipërfaqe 49733m² me numër të ri kadastral 968-1 pronarit të vjetër.

VËREJTJE: KËTO SIPËRFAQE MUNDË TË NDRYSHOJNË NË PERMASA TË VOGLA GJATË PROCSIT TË MATJEVE NË TEREN.

LEGJENDA

-  PARCELA KADASTRALE
-  NR. PARCELE
-  NDARJA E PARCELËS
-  NR. PARCELE E RE

Propozimi për shkëmbimin e pronave të paluajtshme në zonën kadastrale Nikaj.



Makfire Malsiu

From: Gëzim Sahiti
Sent: Thursday, November 14, 2019 2:32 PM
To: Makfire Malsiu
Cc: Kemajl Murseli
Subject: Kerkesw per plotesim tw lendes per vlersimin e vendimit 01.nr.941/04-34155/2019,

Të nderuar/a

Ashtu siç përcaktohet me Ligjin NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS përkatësisht Neni 24 paragrafi 4 te na përcillni vendimin për shpallje te interesit të përgjithshëm ne mënyrë që ta vlerësoni ligjshmërinë e Vendimi 01.nr.941/04-34155/2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës P.K.Nr.00968-2 me pronën e paluajtshme private parcelat kadastrale 00091-1 dhe 00092-2 në emër të Ramiz Palloshit nga Biçeci.

KAPITULLI III KËMBIMI I PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 24

Kushtet për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

1. Komuna ka të drejtë të këmbjë pronën e paluajtshme të komunës me persona fizik dhe juridik.
2. Prona e paluajtshme e komunës mund të këmbëhet vetëm për sigurimin e pronës për qëllime të përmbushjes së interesit publik, në përputhje me kompetencat ligjore të nivelit të qeverisjes lokale.
3. Për fillimin e procedurave të këmbimit të pronës së komunës, obligohet kryetari i komunës që paraprakisht të siguroj raport zyrtar të vlerësimit se nuk ekzistojnë prona tjera të komunës të përshtatshme për këtë qëllim.
4. Në bazë të rekomandimeve nga raporti profesional nga paragrafi 3 i këtij neni, prona e cila këmbëhet duhet të jetë shpall paraprakisht nga Kuvendi i Komunës si pronë me interes publik, përveç nëse nevoja për pronën e tillë arsyetohet në plan të zhvillimore të komunës.
5. Për realizimin e këmbimit të pronës paraprakisht duhet të jenë të siguruar mjetet financiare për realizimin e projektit me interes publik.
6. Prona e paluajtshme e komunës e cila jepet për këmbim duhet të mos ketë kontest gjyqësor.

Me respekt!

Gëzim Sahiti

Zyrtar i lartë për Monitorim të Komunave
Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

☎ 038/200-35-574 Mob. +383 44 393-313

✉ gëzim.sahiti@rks-gov.net

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë (ish-Rilindja), kati XI zyra Nr.1117

Ukshin Qallaku

From: Ukshin Qallaku
Sent: Friday, November 15, 2019 12:01 PM
To: Gëzim Sahiti
Subject: Plotsim i lëndës

Përshëndetje ,

Po ju përcjell sqarimin lidhur me vendimin nr01.nr.941/04-34155/2019 ,vendim i cili ka të bëjë me këmbimin e pronës komunale me pronën private

Po ju njoftojmë se parcela në fjalë me nr.00968-0 zona kadastra lë Nikaj –sipas PZHK-së është e paraparë rrugë lokale,

Rruga në fjalë është ndërtuar me vet kontribut të fshatit Nikaj dhe Blqec në vitin 1987.

Numrat e parcelave 00091-1 dhe parcelës 00092-2, si dhe parcela 00968-1 , nuk janë ende numra zyrtar deri në plotfuqishmëri e vendimit.

**Me Respekt,
Ukshin Çallaku**

Komuna Kaçanik
Drejtor i DUKMM-së
038 /200-46 425 & 044 173 052
ukshin.qallaku@rks-gov.net
<https://kk.rks-gov.net/kacanik/>